

platforma

**CiviKos**




**Drejt bashkëpunimit të  
strukturuar në mes  
shoqërisë civile dhe  
autoriteteve publike në  
Kosovë**

*Dokument për diskutim*

Analizë e praktikave të mira të bashkëpunimit nga rajoni dhe  
Europa

Janar 2011



Tabela

1.	Hyrje.....	4
2.	Strategjia e Bashkëpunimit Shoqëri Civile - Qeveri .....	5
2.1.	Përse është e nevojshme kjo strategji? .....	5
2.2.	Parimet e bashkëpunimit .....	7
2.2.1	Partneriteti.....	7
2.2.2.	Përfaqësimi .....	8
2.3.	Institucionet shtetërore që mund të përfshihen në bashkëpunimin me Shoqërinë Civile	8
2.3.1.	Marrëveshjet e aprovuara në Parlament .....	8
2.3.2.	Marrëveshjet e aprovuara nga Qeveria.....	9
2.3.3.	Bashkëpunimi në kuadër të Ministrive .....	9
2.3.4.	Krijimi i Këshillave të përbashkët.....	9
2.3.5.	Iniciativat nga pushteti lokal.....	10
2.4.	Shoqëria Civile .....	10
2.4.1.	Kujdesi nga humbja e autonomisë së OSHC-ve .....	12
3.	Objektivat e Strategjisë–Fushat e bashkëpunimit.....	12
3.1.	Avansimi i kornizës ekzistuese ligjore për funksionimin e organizatave të shoqërisë civile	12
3.2.	Përkrahja financiare (direkte dhe indirekte) e qeverisë ndaj organizatave të shoqërisë civile	14
3.2.1	Financimi indirekt .....	14
3.2.2.	Financimi direkt .....	15
3.2.3.	Format e grumbullimit të fondeve për financimin e shoqërisë civile .....	16
3.2.4.	Menaxhimi i fondeve .....	17
3.2.5.	Shpërndarja e fondeve.....	17
3.3.	Kontraktimi i disa shërbimeve publike tek shoqëria civile .....	18
3.4.	Fuqizimi i pjesmarrjes së shoqërisë civile në vendim-marrje .....	19
3.5.	Roli i shoqërisë civile në integrimin e Kosovës në BE .....	21
4.	Historiku i bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe qeverisë në Kosovë.....	22

## **Përmbledhje ekzekutive**

Shoqëria civile dhe autoritetet publike, e sidomos Qeveria, janë në një fazë të intensifikimit të ndërveprimeve të tyre. Rregullimi i kornizës ligjore për një ambient favorizues për funksionimin e sektorit, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në draftimin e politikave dhe ligjeve, nevoja për ofrime të disa shërbimeve publike nga OShC-të, nevoja e përkrahjes direkte dhe indirekte të shoqërisë civile nga fondet qeveritare dhe publike si dhe fusha tjera janë bërë ose do të bëhen së shpejti çështje të domosdoshme që do ta përcaktojnë kahjen e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë.

Aktualisht, ky ndër-veprim është duke ndodhur pa rregulla të qarta dhe mekanizma të strukturuar të cilat do të harmonizojnë pritjet e të dyja palëve rreth kontributit dhe përfitimeve nga ky proces. Shumica e ndërveprimeve mes dy sektorëve ndodh në baza personale dhe shpesh herë pa përfshirjen e nevojshme të të gjithë aktorëve relevantë, duke e lënë të pashfrytëzuar sa duhet potencialin që shoqëria civile ka për t'ia ofruar shoqërisë në përgjithësi.

Në këtë kuadër, organizatat e shoqërisë civile duhet të gjejnë formën më të mirë të organizimit formal mes tyre me qëllim të përfaqësimit të duhur si sektor në raport me autoritetet publike. Një platformë që do të përfshinte shumicën e OShCve aktive në Kosovë dhe e cila do të kishte mekanizma të qartë të vet-rregullimit, menjëherë mund të nxisë përcaktimin e kornizës formale të bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës, nëpërmjet hartimit dhe propozimit të një Strategjie për Bashkëpunim. Kjo Strategji do të përfshinte një numër fushash të rëndësishme siç janë avancimi i kornizës ligjore për shoqërinë civile, përfshirja e shoqërisë civile në vendim-marrje, nxitja dhe definimi i përkrahjes direkte dhe indirekte për sektorin e shoqërisë civile, nxitja dhe definimi i ofrimit të disa shërbimeve publike nga OShC-të, përfshirja konkrete e shoqërisë civile në procesin e integritetit evropian të Kosovës etj.

Definimi i prioriteteve afat-shkurta dhe afat-mesme në kuadër të kësaj Strategjie, bashkë me një plan-veprimi që do të përcaktonte qartë bartësit e obligimeve dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira do të ishte hapi i parë drejt fillimit të implementimit të këtij dokumenti, i cili rregullisht duhet të ri-shikohet dhe përditësohet, varësisht nga rezultatet e arritura dhe nevojat e evidentuara. Një mekanizëm mbikqyrës i përbërë nga pjesëtarë të të dyja sektorëve mund të mandatohej për t'u kujdesur që kjo Strategji po implementohet në bazë të marrëveshjes, ose të parandalonte të kundërtën.

Platforma e shoqërisë civile nuk do të duhej të zëvendësonte aktivitetet e organizatave anëtare. Ajo detyrën kryesore do të kishte nxitjen dhe mirëmbajtjen e mekanizmave të bashkëpunimit dhe koordinimin e punës së OShCve anëtare rreth dhënies së kontributit dhe marrjes së përfitimeve nga këto mekanizma. OShCtë anëtare, por edhe të tjerat, do të vazhdonin të kryenin punët e tyre bazuar në misionet dhe qëllimet e tyre specifike, por tanimë duke pasur rregulla të qarta të ndërveprimit të tyre me autoritetet publike dhe një mekanizëm të vetin i cili do t'i mbronte dhe do të kujdesej që rregullat po zbatohen.

Për të ndodhur kjo, organizatat e shoqërisë civile duhet të marrin përgjegjësitë të cilat u takojnë dhe të angazhohen që ta fuqizojnë sektorin e tyre me qëllim që të jenë partner i barabartë me Qeverinë dhe autoritetet tjera publike përgjatë të gjitha bashkëveprimeve me ta. Vetëm një shoqëri civile mirë e organizuar mund të garantojë që ky bashkëpunim do të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe në bazë të rregullave qartë të definuara, duke e bërë potencialin e këtij sektori të shfrytëzueshëm maksimalisht dhe duke minimizuar keqpërdorimet e mundshme me dhe rreth sektorit të shoqërisë civile.

*“Pavarësisht nëse Organizatat e Shoqërisë Civile ndërveprojnë me shtetin në mënyrë bashkëpunuese ose kritikuese e konfrontuese, atyre u duhet që ky ndërveprim të jetë formal, transparent dhe të zhvillohet në bazë të rregullave paraprakisht të njohura.”-*

Një aktivist i shoqërisë civile nga Europa Lindore, duke komentuar bashkëpunimin mes Qeverisë dhe shoqërisë civile në këto vende

## **1. Hyrje**

Në demokracitë moderne, të cilat bazohen në ekonominë e tregut, qeverisja e mirë varet në masë të madhe nga marrëdhënja në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile. Në kushte të ndryshimeve dhe zhvillimeve të vazhdueshme demokratike dhe në rrethana të promovimit të formave inovative të qeverisjes, hartimi i politikave të qëndrueshme publike dhe ofrimi i shërbimeve sociale nuk mund të jetë më e drejtë ekskluzive e përfaqësuesve politik. Atyre u duhen partnerë kompetentë jashtë qeverisë të cilët do ti ndihmonin në krijimin e politikave të efektshme publike dhe në implementimin e intervenimeve efektive për qytetarët e tyre. Në këtë proces, një rol unik mund t'i atribuohet shoqërisë civile, qoftë në inicimin, organizimin dhe udhëheqjen e debateve gjithëpërfshirëse për të adresuar kërkesat prioritare të qytetarëve apo në ofrimin dhe plotësimin e shërbimeve sociale për banorët.

Për të filluar procesin e mirëfilltë të bashkëpunimit, të dy sektoret duhet të njohin vlerat e përbashkëta, të pranojnë përgjegjësitë e përbashkëta rreth çështjeve të caktuara si dhe të shkëmbejnë burimet e tyre financiare dhe njerëzore për realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim do të mbulojë mangësitë e të dy sektoreve por pa i dëmtuar pikat e forta të tyre. Poashtu, që bashkëpunim të jetë i suksesshëm, secili nga partnerët duhet të ketë shkallë të lartë të integritetit, duhet të ruaj besimin reciprok si dhe duhet të ketë legjitimitet përfaqësimi. Është shumë e rëndësishme që organizatat e shoqërisë civile të mos humbin vlerat e tyre dhe të politizohen gjatë këtij procesi. Ndonëse objektivat dhe metodat mund të jenë të ndryshme, qëllimi i përbashkët i të dy sektoreve për bashkëpunim të ndërsjellë është i rëndësishëm së lartë, përndryshe nuk mund të ketë partneritet efektiv.

Në rastin e Kosovës, qeveria dhe shoqëria civile kanë një histori relativisht të re të zhvillimit dhe kjo do të duhej të shihej si avantazh për të krijuar një bashkëpunim të mirëfilltë në mes të këtyre dy sektorëve. Shoqëria civile (pjesa më e madhe e saj) dhe qeveria në Kosovë, e kanë filluar zhvillimin e tyre real pas viti 1999, në një situatë në të cilën pothuajse çdo gjë duhej të ndërtohej nga fillimi. Sot, njëmbëdhjetë vite më pas, organet qeveritare ende janë duke mësuar se si t'i hartojnë politikat publike, se si t'i implementojnë ligjet dhe rregulloret në mënyrë transparente, apo si të ofrojnë shërbime që u përgjigjen nevojave të qytetarëve. Në anën tjetër organizatat e shoqërisë civile ende janë duke punuar në ngritje të kapaciteteve të tyre në mënyrë që të jenë përfaqësues sa më të denjë të interesave të qytetarëve. Ato po përpiqen të koordinojnë aktivitetet e tyre dhe po tentojnë që të jenë pjesëmarrës aktiv në dizajnimin dhe krijimin e politikave publike si dhe në monitorimin e qeverisë dhe mbajtjen përgjegjëse të saj përmes mekanizmave të llogaridhënjes dhe transparencës.

Megjithatë, përpos disa iniciativave të papërfunduara dhe në disa raste të vullnetit politik të disa udhëheqësve në Kosovë, bashkëpunimi në mes organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisë ka ngelur akoma në nivel sporadik. Në rastet e rralla kur ky bashkëpunim ndodhë, ai është më tepër rezultat i kontakteve apo njohjeve personale të politikanëve dhe përfaqësuesëve të shoqërisë civile ose rezultat i nevojës së politikëbërësve për të përmirësuar imazhin e tyre publik. Shpesh herë, kjo formë e bashkëpunimit ad-hoc është kritikuar nga vet organizatat e shoqërisë civile, të cilat pretendojnë se janë lënë anash forumeve dhe diskutimeve të rëndësishme vetëm për faktin që nuk kanë pasur kontakte e njohje personale me vendim-marrësit, duke bërë që qeveria t'i ftojë në bashkëpunim vetëm ato organizata që i konsideron të afërta me të, e me këtë të pretendojë që ka përmbushur obligimin e konsultimit të këtij sektori. Në anën tjetër, politikë-bërësit arsyetohen me faktin se shoqëria civile është aq e gjërë dhe aq e paorganizuar, saqë e kanë të pamundur që t'i kenë informatat e sakta se cilën organizatë apo përfaqësues të shoqërisë civile duhet ftuar në aktivitetet specifike. Për pasojë, e gjithë ekspertiza e cila është akumuluar gjatë këtyre viteve në mesin e organizatave të shoqërisë civile ka ngelur në masë të madhe e pashfrytëzuar nga vendimmarrësit në Kosovë.

Krijimi i bashkëpunimit të strukturuar në mes shoqërisë civile dhe qeverisë është shumë i rëndësishëm në rrethanat aktuale në Kosovë. Po dëshmohet çdo ditë e më tepër se ndërtimi i shtetit dhe krijimi i mekanizmave funksionale të cilët ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarit të Kosovës nuk mund të bëhen nga asnjëri sektor në mënyrë individuale. Ndërveprimet mes shoqërisë civile dhe autoriteteve publike, e në veçanti qeverisë, janë duke u shtuar vazhdimisht – me apo pa dëshirën e palëve. Në rast se nuk bazohen në njohjen e vlerave reciproke, përafrimin e pritjeve dhe përcaktimin e rregullave të lojës si dhe shfrytëzimin maksimal të burimeve të të dyja palëve, ky ndërveprim jo gjithëherë do të arrijë që të ndikojë për të mirë në jetën e qytetarëve të vendit, e ndonjëherë mund të sjellë edhe në situata të palakmueshme, qoftë për shoqërinë civile ashtu edhe për qeverinë.

Në shumicën e vendeve të rajonit dhe Europës tashmë janë krijuar mekanizma formal të cilët e rregullojnë rolin e shoqërisë civile si partner të mirëfilltë të qeverisë. Në shumë raste roli i shoqërisë civile qoftë në zhvillimin e demokracisë së brendshme apo në procesin e integritit europian ka qenë esencial.

## **2. Strategjia e Bashkëpunimit Shoqëri Civile - Qeveri**

### **2.1. Përse është e nevojshme kjo strategji?**

Me rastin e krijimit të bashkëpunimit në mes sektoreve, pas njohjes së rolit reciprok nga të dyja palët, parakushti kryesor është krijimi i kornizës legale apo formale që do të rregullonte këtë bashkëpunim. Kjo kornizë do të krijonte një platformë në të cilën këto marrëdhënie mund të zhvillohen dhe përforcohen në vazhdimësi, duke minimizuar mundësinë e keqpërdorimit ose keqkuptimit të këtij bashkëpunimi nga cilado palë.

Nxjerrja e një strategjie formale të bashkëpunimit në mes të dy sektorëve është shumë e rëndësishme në kontekstin e tanishëm në Kosovë. Qytetarët e Kosovës po marrin pjesë gjithnjë e më pak në proceset demokratike në vend. Shembull konkret mund të konsiderohet dalja në zgjedhje që është zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme që nga zgjedhjet e para lokale të vitit 1999. Poashtu, besimi i qytetarëve në institucionet qeveritare ka pësuar rënie të vazhdueshme dhe është në fazë kritike.

Shoqërisë civile në Kosovë i duhet strategjia për të krijuar dhe garantuar mekanizma që do të mundësonin draftimin e politikave më të mira publike të cilat do të bazoheshin në informatat e drejtpërdrejta të marra nga ana e qytetarëve. Kjo do të nënkuptonte edhe implementim më të suksesshëm të këtyre politikave pasi që qytetarët do të ishin më të informuar për këto politika për faktin që kanë marrë pjesë të drejtëpërdrejtë në dizajnimin e tyre.

Nga ana e tyre, politikëbërësit në Kosovë të ballafaquar me trendin e rënies së besimit ndaj tyre, janë në presion për të aktivizuar qytetarët apo për t'u lidhur me ta në forma të reja. Atyre i'u duhet të shfrytëzojë këtë shansë për të bashkëpunuar me shoqërinë civile për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve të cilat i'a ofrojnë qytetarëve, për të reduktuar shpenzimet si dhe për të dizajnuar politika të efektshme që do të rrisin zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit. Atyre i'u duhet ky bashkëpunim përveq tjerash edhe për të përmirësuar imazhin gjithnjë në rënie të tyre në raport me qytetarët.. Pjesëmarrja e qytetarëve në dizajnimin e politikave publike, qoftë drejtpërdrejtë apo përmes organizatave të shoqërisë civile e rritë besueshmërinë e tyre ndaj institucioneve qeveritare sepse përmes kësaj pjesëmarrjeje ata mësojnë më shumë rreth proceseve dhe mënyrave se si qeveria i merr vendimet e saja dhe në të njëjtën kohë sigurohen që zëri i tyre është dëgjuar me rastin e aprovimit të këtyre dokumenteve. Gjithashtu, shoqëria civile do të përmirësonte pozicionimin e saj në drejtim të mbajtjes së qeverisë të përgjegjshme në raport me qytetarët.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe joefikasiteti apo pamundësia e shtetit për të ofruar shërbime publike që iu përshtaten kërkesave në rritje të qytetarëve. Kohët e fundit ka pasur një njohje pozitive të kontributit dhe potencialit të organizatave të shoqërisë civile të cilat jo vetëm ofrojnë zgjedhje në ofrimin e shërbimeve, por ofrojnë një shansë për të gjeneruar besimin, vlerat qytetare dhe kapitalin social përmes pjesëmarrjes në jetën publike.

Si përfundim, bashkëpunimi në mes të dy sektoreve në Kosovë duhet të ndodhë jo vetëm për arsye sociale dhe politike por edhe për arsye ekonomike. Më poshtë janë dhënë disa nga arsyet kryesore se pse qeveria duhet të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë:

#### *Arsyet ekonomike*

- Organizatat multilaterale (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj) dhe donatorët tjerë të mëdhenj tani besojnë më pak në aftësinë e qeverive dhe tregut që të vetme të sjellin zhvillime të qëndrueshme shoqërore. Roli i ndërmarrësisë sociale ka zënë vend të pazëvendësueshëm në gjetjen e zgjidhjeve inovative për çështjet sociale.
- Nevojat e rritura për shpenzime në fushën e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe edukimit në njërën anë dhe limitimet buxhetetore në anën tjetër, e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimin e qeverisë me shoqërinë civile për të "ndarë barrën" e përgjegjësisë.
- Përgjegjësitë e rritura të pushtetit lokal për të ofruar shërbime në fushat e përmendura më lartë nuk mund të përcillen me rritje adekuate të fondeve nga qeveria qendrore, andaj bashkëpunimi apo delegimi i përgjegjësisë tek sektori i tretë bëhet i domosdoshëm.
- Aftësia e rritur e sektorit joqeveritarë për të tërhequr fonde për ofrimin e shërbimeve sociale përmes ndërmarrësisë sociale duhet të shfrytëzohet.
- Shërbimet e sektorit joqeveritarë janë më të lira dhe sjellin vlera të reja (krahasuar me sektorin privat p.sh.)

## *Arsyet politike dhe sociale*

- Trendet regjionale dhe ato të Bashkimit Europian tregojnë vullnetin e qeverive për të rritur rolin e shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje
- Partneriteti në mes shoqërisë civile, qeverisë dhe sektorit privat shpesh shihet si mënyra më efektive e zgjidhjes së problemeve komplekse socio-ekonomike.
- Kapitali social (dëshira dhe kapaciteti i rritur i qytetarëve për tu përfshirë në çështje publike) shihet si komponentë e rëndësishme e zhvillimit dhe rritjes ekonomike të një vendi.
- Sektori joqeveritarë është i motivuar nga përfitimi që nxjerr shoqëria, e jo nga përfitimi që nxjerrin vetë OSHC-të.
- Vendimmarrja pluraliste dhe gjithëpërfshirëse është mjet për të gjeneruar konsensusin social rreth politikave të reja dhe reformave.

Për funksionimin e suksesshëm të këtij bashkëpunimi nevojitet të caktohen qartë principet dhe pjesëmarrësit e këtij bashkëpunimi.

## **2.2. Parimet e bashkëpunimit**

### **2.2.1 Partneriteti**

Suksesi në implementimin e strategjisë së bashkëpunimit në mes të sektoreve me siguri që kërkon më shumë se sa vetëm aprovimin formal të dokumentit. Megjithatë, është mirë të potencohet se – procesi, dhe jo vetëm dokumenti i prodhuar - është po aq me rëndësi, që do të thotë se edhe në rastet kur të dy palët nuk pajtohen rreth ndonjë objektive apo rreth metodave të implementimit të bashkëpunimit ato prap se prap mund të përfitojnë nga negociatat dhe nga kontaktet e drejtpërdrejta. Pra, qeveria dhe shoqëria civile mund të ndërtojnë një partneritet më të fortë dhe komunikim më të mirë përmes procesit të negociatave, pikërisht përmes kontakteve më të shpeshta, diskutimeve konstruktive, bashkëpunimit aktiv, kompromiseve dhe kuptimit të ndërsjellë.

Nga përvojat e vendeve tjera të cilat kanë aprovuar dokumente bashkëpunimi në mes të dy sektoreve janë nxjerrur këto mësimë që mund të shërbejnë gjatë procesit të miratimit të strategjisë së bashkëpunimit edhe në Kosovë:

- Në proces duhet të involvohen sa më shumë aktorë nga qeveria, shoqëria civile dhe publiku i gjërë.
- Gjatë draftimit të dokumentit duhet të punohet ngushtë me ekspertë nga fusha të ndryshme sidomos me ekspertë ligjorë.
- Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet monitorimit dhe implementimit të strategjisë si dhe raportimit të rezultateve të implementimit.
- Përpos strategjisë duhet të përpilohet edhe një plan i veprimit me aktivitetet e ardhshme ku përshkruhet qartë edhe roli edhe përgjegjësia e secilit.
- Duhet të zgjedhet momenti më i përshtatshëm për nxjerrjen e dokumentit dhe për fillimin e implementimit.
- Nxjerrja e strategjisë duhet të përcillet me informim të mirë të institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile dhe publikut që secili të kuptojë përfitimet dhe përgjegjësitë që dalin nga ky dokument.

### **2.2.2. Përfaqësimi**

Një aspekt shumë i rëndësishëm në procesin e krijimit të partneritetit në mes institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile në Kosovë është edhe çështja e përfaqësimit. Kush e ka mandatin nga shoqëria civile në Kosovë që të futet në dialog me qeverinë në krijimin e këtij partneriteti? Si do ti zgjedhin ata përfaqësuesit e tyre në mekanizmat që do të krijohen si rezultat i aprovimit të dokumentit të bashkëpunimit? Sa është përbindja e organizatave të shoqërisë civile që janë të interesuara apo mund të përfitojnë nga ky bashkëpunim i strukturuar? A duhet patjetër të përfshihet e gjithë shoqëria civile, apo një pjesë e konsiderueshme e saj mund të marrë rolin e nisjes së këtij bashkëpunimi? Përvoja nga vendet e rajonit tregon se pikërisht këto pyetje do të duhet të marrin përgjegje para se të fillojë puna konkrete në funksionalizimin e një bashkëpunimi të mirëfilltë në mes sektoreve.

Nga ana tjetër shteti këtë problem e ka gati se të zgjidhur. Atë mund ta përfaqsojnë në këtë bashkëpunim nivele të ndryshme të qeverisjes – parlamenti, qeveria, ministritë apo edhe ndonjë institucion tjetër i nivelit lokal. Teksti më poshtë përshkruan përvojat e ndryshme nga rajoni dhe më gjërë rreth institucioneve shtetërore që marrin rolin udhëheqës në bashkëpunimin me shoqërinë civile.

### **2.3. *Institucionet shtetërore që mund të përfshihen në bashkëpunimin me Shoqërinë Civile***

Bashkëpunimi në mes të sektorit qeveritar dhe atij të shoqërisë civile mund të ndodhë në nivele të ndryshme të qeverisjes, duke filluar që nga parlamenti, përmes ministrive e deri te pushteti lokal apo edhe institucionet e pavarura. Partneriteti në shumicën e rasteve është specifik për një vend të caktuar dhe shumica e vendeve e ka zhvilluar atë partneritet gjatë një kohe të gjatë duke kaluar nëpër specifikat e veta. Në përgjithësi, në shumicën e vendeve europiane ky bashkëpunim ka filluar në sektorët specifike sikurse ato të shërbimeve sociale apo në fushën e mbrojtjes së ambientit ku kryesisht bashkëpunimi është i domosdoshëm, por që ka qenë e rëndësishme së lartë pasi që ka vazhduar më pas me forma tjera të bashkëpunimit.

Më poshtë përshkruhen disa nga përvojat më interesante nga vendet Europiane në raport me nivelin qeverisës ku është aprovuar marrëveshja e bashkëpunimit.

#### **2.3.1. Marrëveshjet e aprovuara në Parlament**

Shembujt kur bashkëpunimi në mes sektoreve iniciohet nga parlamenti i gjejmë në Hungari dhe Gjermani. Në Hungari, Komisioni Parlamentar për Përkrahje të Organizatave Civile ekziston që nga fillimi i viteve 90' dhe një kohë ka pasur mandatin e dhënies së granteve për organizatat joqeveritare kurse tani e ka kryesisht përgjegjësinë në përgatitjen e legjislacionit që ka të bëjë me shoqërinë civile. Në Hungari ekziston edhe Zyra Civile e Parlamentit e cila mirëmbanë nja bazë të dhënash të OSHC-ve vendore tek të cilat i përcjell vazhdimisht ligjet dhe rregulloret që aprovohen në Parlament e që janë të lidhura me fushat e veprimtimit të atyre organizatave, sikurse që koordinon edhe përfshirjen e këtyre organizatave në punën e Parlamentit. Në Gjermani ndërkaq, ekziston Nënkomisioni për Çështjet e Familjes, Qytetarëve të Moshuar, Grave dhe të Rinjve, i themeluar në vitin 2003 i cili e ka mandatin për të ndihmuar implementimin e rekomandimeve të cilat kanë dalë nga një studim për shoqërinë civile i kryer para një kohe në Gjermani. Shtete të ndryshme e kanë të rregulluar në mënyra të ndryshme këtë bashkëpunim, mirëpo qëllimi i të gjitha formave të ndryshme është lehtësimi i përfshirjes së shoqërisë civile në punën e Parlamenteve dhe shfrytëzimi i ekspertizës dhe përfaqësimit të saj në procesin e hartimit të politikave dhe ligjeve të një vendi.



### **2.3.2. Marrëveshjet e aprovuara nga Qeveria**

Përveç rasteve kur bashkëpunimi në mes sektoreve zhvillohet nga ministrinë veç e veç, ekzistojnë edhe raste kur ky partneritet inicohet dhe implementohet nga niveli qendror i qeverisë, (p.sh. në Hungari, Kroaci dhe Slloveni). Në Hungari, Departamenti për Çështje Civile në kuadër të zyrës së Kryeministrit, i themeluar në vitin 1998 kishte mandat për të zhvilluar bashkëpunimin me shoqërinë civile. Ky departament ka zhvilluar strategjinë për zhvillimin e shoqërisë civile në Hungari. Momentalisht ky departament është shkrirë në Zyrën për Shanse të Barabarta.

Sllovenia në anën tjetër kishte zgjedhur një koordinator nacional për bashkëpunim me shoqërinë civile i cili ishte zgjedhur nga Zyra për Çështje Europiane. Roli i koordinatorit ishte për të krijuar një çasje të koordinuar dhe sistematike të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Në të dy rastet (Hungari dhe Slloveni) ky bashkëpunim ishte inicuar si pjesë e angazhimeve të qeverive të këtyre vendeve për integrim në BE apo më konkretisht në përfshirjen e OSHC-ve në përgatitjen e Planit Zhvillimor Nacional. Në Kroaci, në vitin 1998 ishte themeluar Zyra Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Kjo zyrë ka koordinuar aktivitetin e shumë grupeve në aprovimin e legjislacioneve të ndryshme si dhe ka shërbyer si dhënësi i granteve deri në momentin kur kjo përgjegjësi i është kaluar Këshillit për Shoqëri Civile (një institucion këshillëdhënës i qeverisë). Kjo Zyre udhëhiqet nga ish aktivistë të dalluar të shoqërisë civile dhe angazhohet që të fuqizojë praninë e organizatave të shoqërisë civile në të gjitha strukturat dhe nivelet e vendim-marrjes në këtë vend.

### **2.3.3. Bashkëpunimi në kuadër të Ministrive**

Në shumicën e vendeve bashkëpunimi më i theksuar dhe më natyral në mes sektoreve ndodh në mes ministrive specifike dhe OSHC-ve që punojnë në fushat që i mbulon ajo ministri. Normalisht, në këtë rast ekziston interesi i përbashkët i cili për OSHC-të nënkupton sjelljen e ligjeve dhe rregulloreve që reflektojnë kërkesat e anëtarësisë së tyre ndërsa për ministrinë nënkupton ndihmën që OSHC-të mund të japin në hartimin dhe implementimin e politikave nacionale. Edhe në Kosovë ekziston një lloj i bashkëpunimit të tillë, p.sh. MKRS organizon çdo vit muajin rinor në bashkëpunim me OSHC-të rinore. Rast tjetër është edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar në vitin 2008 ndërmjet 30 OJQ-ve mjedisore dhe MMPH-s (Ministrit të MMPH-së), në kuadër të një projekti të mbështetur nga Komisioni Europian dhe të implementuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC). Kjo Marrëveshje vendos bazat për një bashkëpunim formal mes sektorit qeveritar dhe joqeveritar në fushën e mjedisit, por ende nuk dihet nëse ka ndonjë rast konkret ku OJQ-t mjedisore kanë shfrytëzuar në favor të vetin klauzolat mjaft pozitive të kësaj Marrëveshje.

### **2.3.4. Krijimi i Këshillave të përbashkët**

Ndonjëherë ky bashkëpunim udhëhiqet nga një organizëm formal këshillëdhënës i cili përbëhet nga anëtarë të të dy sektoreve, sikurse është p.sh. Këshilli i Qeverisë Sllovaqe për Bashkëpunim me OSHC-të apo Këshilli për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Kroaci i themeluar në vitin 2002 i cili përbëhet nga 10 përfaqësues të qeverisë dhe 14 përfaqësues të shoqërisë civile dhe ka mandatin për të implementuar Planin e Bashkëpunimit në mes sektoreve. Këto Këshilla zakonisht janë karakteristike për format e centralizuara të bashkëpunimit, siç janë marrëveshjet e bashkëpunimit të nivelit qeveritar, por mund të kenë për detyrë edhe mbikqyrjen e implementimit të marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit.

### **2.3.5. Inicijativat nga pushteti lokal**

Format e bashkëpunimit në nivel lokal zakonisht reflektojnë format dhe praktikat e ndjekura edhe nga niveli qendror. Në Poloni qyteti i Szczecin ka hapur në vitin 1997 një zyrë për OSHC-të që ofronte ndihmë OSHC-ve dhe në shumë raste shërbente si “ombudsperson” për këto organizata në kontestet me autoritetet lokale. Gjithashtu, kjo zyrë ka krijuar Fondin për Grante të Vogla, të cilat janë në dispozicion të OSHCve lokale për aktivitetet e tyre të përditshme. Në Britani të Madhe, marrëveshja e bashkëpunimit mes sektorit të tretë dhe autoriteteve publike e njohur me emrin “Compact” ka vite që është shtrirë edhe në të gjitha strukturat e pushtetit lokal. Tanimë secila njësi lokale ka të nënshkruar dhe implementon Compact-in lokal, i cili në vete përfshin parimet dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në konsultime publike, vendim-marrje, ofrim të shërbimeve sikurse edhe përcakton parimet e financimit publik të këtyre organizatave.

Një formë inovative e këtij bashkëpunimi në nivel lokal paraqet edhe Shërbimi i Zyrës Këshilluese për Qytetarë. Ky lloj shërbimi ku OSHCtë i ofrojnë qytetarëve këshilla pa pagesë, konfidenciale dhe të pavarura lidhur me cilatdo probleme të jetës së tyre të përditshme ekziston tanimë në mbi 2,800 qytete të Anglisë, Uellsit dhe Irlandës së Veriut, ndërsa financohet nga buxhetet lokale dhe donacionet individuale. Këto zyra ndihmojnë në zgjidhjen e mbi 6 milion rasteve në vit.

### **2.4. Shoqëria Civile**

Shoqëria civile në Kosovë, edhe pse në forma dhe nivele të caktuara ka ekzistuar edhe më herët, organizimin dhe formën aktuale ka filluar ta marrë që nga viti 1999, kohë kur ka marrë hov zhvillimii saj qoftë në numër apo përfshirje të fushave të ndryshme të jetës. Të gjendur në një situatë emergjente, me institucionet shtetëore në hapat e parë të zhvillimit dhe pa mundësi të mëdha për të ofruar shërbimet e nevojshme për qytetarë, qytetarët e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë themeluan një numër shumë të madh të organizatave të shoqërisë civile (kryesisht në formë të organizatave jo-qeveritare), të cilat u cilësuan si mekanizmi më i përshtatshëm për të absorbuar fondet e emergjencës dhe rindërtimit dhe ofrimin e shërbimeve bazike për vendin e dalë nga lufta. Përkundër rolit të saj thelbësor në tejkalimin e kësaj faze, shoqëria civile kaloi edhe nëpër vështirësi të shumta të cilat po e përcjellin këtë sektor sot e kësaj dite. Shumica e organizatave të regjistruara (që aktualisht janë rreth 6,000) tanimë nuk janë funksionale.

Me ngritjen e hovshme të këtij sektori filluan edhe përpjekjet për rrjetëzim të OShCve, përpjekje këto që në shumicën e rasteve nuk u treguan të suksesshme. Arsyet për këtë mos-sukses ishin nga më të ndryshmet, por disa ndër to përfshijnë nxitjen e rrjetëzimit nga donatorët e jo nga vet kërkesat e organizatave anëtare, mos-përcaktimin e qartë të qëllimeve dhe kontributit e përfitimeve të anëtarëve nga rrjetet e ndryshme si dhe mungesën e trupave koordinuese që do të mbanin të informuar dhe aktivë anëtarët.

Megjithatë, disa nga këto rrjete i kanë mbijetuar kohës dhe vazhdojnë të funksionojnë, sikurse që është Rrjeti i Grave të Kosovës. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile janë aktive edhe në rrjete jo-formale dhe “ad-hoc”, të cilat janë aktivizuar për çështje të caktuara. Një ndër to është Grupi Këshillues për Avokim, rrjet ky jo-formal i cili mbledh rregullisht i një numër organizatash të shoqërisë civile në Kosovë,

të cilat diskutojnë dhe avokojnë bashkërisht për çështjet në interes të përgjithshëm. Në fillim i fokusuar kryesisht në Kuvendin e Kosovës, aktualisht Grupi Këshillues për Avokim ka zgjeruar interesin e tij edhe në çështje tjera të cilat prekin drejtpërdrejtë organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e qytetarëve të cilat këto organizata i përfaqësojnë.

Një problem tjetër, jo vetëm në Kosovë, është edhe fakti se shumica e organizatave të shoqërisë civile nuk janë në fakt organizma të zgjedhur por në radhë të parë janë grumbullime njerëzish rreth një qëllimi të caktuar. Teorikisht ato janë pjesë e demokracisë pjesëmarrëse dhe jo demokracisë përfaqësuese. Me fjalë të tjera ato legjitimohen duke marrë pjesë në proceset publike rreth çështjeve që i adresojnë dhe jo duke u zgjedhur nga popullata të cilën pretendojnë se e përfaqësojnë apo për të mirën e së cilës deklarohen se po punojnë. Sfida e legjitimitetit të përfaqësimit duket se do të jetë përherë njëra nga çështjet për të cilat do të debatohet.

Në këtë situatë, është thelbësore të debatohet dhe qartësohet pozicionimi i sektorit të shoqërisë civile karshi shtetit, respektivisht ndër-veprimit me autoritetet publike. Shoqëria civile e ka të domosdoshëm bashkëpunimin me vendim-marrës si njërin nga mjetet e adresimit dhe zgjidhjes së çështjeve rreth së cilave ky sektor angazhohet, si nëpërmjet bashkëpunimit ashtu edhe nëpërmjet kritikave dhe konfrontimit. Duke e parë diversitetin dhe problemet e përfaqësimit të shoqërisë civile, shumica dërmuese e vendeve të Europës kanë zgjedhur që këtë problem ta adresojnë nëpërmjet krijimit të platformave të shoqërisë civile të cilat marrin përgjegjësinë e përfaqësimit formal të këtij sektori në raport me autoritetet publike. Ky përfaqësim formal konsiston kryesisht në definimin e rregullave të bashkëpunimit, mbrojtjen e interesave të sektorit sikurse edhe parandalimin e keq-përdorimit të bashkëpunimit qoftë nga shteti ashtu edhe nga vet organizatat e shoqërisë civile. Vet-rregullimi i sektorit, respektivisht platformave është i ndryshëm nga vendi në vend, mirëpo kryesisht fokusohet në marrjen e përgjegjësisë nga organizatat anëtare, përcaktimin e veprimeve strategjike karshi shtetit dhe mekanizmat e brendshëm të përzgjedhjes.

Realisht, për të arritur deri te një proces i mirëfilltë bashkëpunimi, shumica e OSHC-ve në Kosovë duhet akoma të kalojnë ndryshime strukturale për të ndërtuar një masë kritike të OSHC-ve të cilat kanë njohuri dhe kapacitete për t'u bërë aktorë të rregullt në politikë-bërje në nivelin lokal dhe qendror. Përkundër vështirësive, ato duhet të gjejnë formën për të ndërtuar një koalicion gjithëpërfshirës që përfaqëson shumicën e organizatave vendore dhe që do të ishte një palë e fuqishme ndaj qeverisë në të gjitha format e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Si do që të jetë, në procesin e krijimit të bashkëpunimit në mes qeverisë dhe shoqërisë civile përcaktimi i qartë i përfaqësuesve legjitim do të bënte procesin shumë më të lehtë për t'u realizuar. Ky mekanizëm përfaqësues, detyrën kryesore do të kishte nxitjen dhe mirëmbajtjen e mekanizmave të bashkëpunimit dhe koordinimin e punës së OSHCve anëtare rreth dhënies së kontributit dhe marrjes së përfitimeve nga këto mekanizma. OSHCtë anëtare, por edhe të tjerat, do të vazhdonin të kryenin punët e tyre bazuar në misionet dhe qëllimet e tyre specifike, por tanimë duke pasur rregulla të qarta të ndërveprimit të tyre me autoritetet publike dhe një mekanizëm të vetin i cili do t'i mbronte dhe do të kujdesej që rregullat po zbatohen.

#### **2.4.1. Kujdesi nga humbja e autonomisë së OSHC-ve**

Në fund duhet të themi se interesimi i shtuar i qeverisë për të ndihmuar dhe financuar shoqërinë civile është “thikë me dy teha” sepse mund të vijë deri te politizimi i OSHC-ve dhe kontrollimi i veprimtarive të tyre. Andaj duhet gjithmonë t’i kushtohet kujdes ruajtjes së autonomisë së OSHC-ve dhe të shfrytëzohen përfitimet që i ofron qeveria pa e dëmtuar pavarësinë e veprimeve të OSHC-ve. Qeveria e Kosovës tanimë ka filluar që të financojë organizata të ndryshme, duke filluar nga ato rinore deri te organizatat që ofrojnë shërbime sociale, në kuadër të ministrive të ndryshme të saj. Përkundër që fondet qeveritare dhe ato publike janë të mirëseardhura për sektorin, shpërndarja e tyre pa kritere qartë të definuara dhe jashtë strukturave të përbashkëta të përzgjedhjes e monitorimit (e që aktualisht nuk ekzistojnë) mund të ngrejë dyshime legjitime mbi ndikimin e qeverisë në autonominë e organizatave përfituese të këtyre fondeve.

### **3. Objektivat e Strategjisë–Fushat e bashkëpunimit**

Bazuar në përvojat e mira të rajonit strategjia duhet të konsiderohet vetëm si themel i bashkëpunimit në mes sektoreve dhe duhet të kuptohet shumë më tepër si fillim i këtij bashkëpunimi apo si një proces i cili mund dhe duhet të ndryshohet varësisht nga përvoja gjatë implementimit të elementeve të saj. Strategjia e bashkëpunimit, e cila mund të propozohet nga vet organizatat e shoqërisë civile dhe me pjesëmarrjen e aktorëve tjerë nga qeveria, biznesi e komuniteti i donatorëve, do të përcaktonte vizionin e përbashkët për fushat e mbuluara, shtyllat kryesore të arritjes së këtij vizioni dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit sektor në këtë rrugë. Edhe në rast të pajtimit të shpejtë për përmbajtjen e saj, implementimi i Strategjisë kërkon kohë dhe angazhim të madh. Megjithatë, e nisur njëherë në kuadër të një procesi gjithëpërfshirës dhe përfaqësues, kjo Strategji do të duhej vazhdimisht të mbikqyrej, vlerësohej, zgjerohej dhe përshtatej me nevojat e të dy sektorëve dhe prioritetet strategjike të vendit.

#### ***3.1. Avansimi i kornizës ekzistuese ligjore për funksionimin e organizatave të shoqërisë civile***

Në parim, një bashkëpunim i mirëfilltë i sektoreve fillon me përgatitjen e kornizës ligjore apo ligjeve dhe dokumenteve të cilat mundësojnë funksionimin më të mirë dhe më të lehtë të OSHC-ve dhe të cilat hapin rrugën e bashkëpunimit formal në mes të dy sektoreve. Normalsht, vetëm aprovimi i

dokumenteve formale apo ligjeve dhe rregulloreve nuk mjafton, niveli i implementimit të tyre është shumë më i rëndësishëm.

### **Cila është korniza ligjore për funksionimin e OSHC-ve në Kosovë?**

Kosova që nga viti 1999 ka pasur një Rregullore të UNMIK-ut 1999/22 për regjistrimin e OSHC-ve që është cilësuar si një dokument mjaft i favorshëm për punën dhe funksionimin e OSHC-ve në Kosovë. Regjistrimi i OSHC-ve ka qenë dhe është i shpejtë dhe i lehtë dhe pas regjistrimit ligji i mbrojnë ato nga shteti dhe parandalon shpërbërjen arbitrare të tyre për arsye politike. Organizatat, në të shumtën e rasteve po ashtu nuk janë shqetësuar pa ndonjë arsye nga qeveria apo autoritetet tatimore.

Tentimi i parë i autoriteteve vendore për të shndërruar këtë Rregullore në ligj u ndërmorr në vitin 2005, ku pas disa ndryshimeve të draftit final në seancën e fundit para miratimit, Ligji u kundërshtua nga sektori dhe nuk u nënshkrua nga PSSP, duke mos hyrë asnjëherë në fuqi. Drafti i ngjajshëm u rikthye në diskutim gjatë vitit 2008, ndërsa pas një procesi më të gjatë të konsultimit, u miratua në Shkurt të vitit 2009. Ky ligj, i cili është në fuqi edhe sot, ishte i ngjajshëm me Rregulloren e UNMIK-ut dhe relativisht favorizues për sektorin, megjithatë me shumë probleme teknike dhe logjike brenda tij. Këto bënë që i njëjti të futet në procesin e plotësimit-ndryshimit gjatë vitit 2010, dhe pas një periudhe të gjatë debatesh e konfrontimesh, u përfundua nga Grupi Punues Qeveritar në Shtator të këtij viti, për të pritur shqyrëtimin nga Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2011.

Ligji bazë për OJQ, sado i mirë që të jetë, megjithatë nuk mjafton për të rregulluar funksionimin e sektorit jo-qeveritar dhe krijimin e ambientit favorizues për punë. Pjesa tjetër e kornizës ligjore ose mungon në tërësi ose është e mangët. Disa nga fushat që duhet të përfshihen në kornizën ligjore që e prekin sektorin e shoqërisë civile në Kosovë janë:

- Përcaktimi i lehtësirave fiskale për OSHCtë me status të përfituesit publik – lehtësira këto për të cilat Ligji për OSHC i hap dyert, por të cilat duhet të rregullohen me ligjet tjera si ai për TVSH, Dogana, Tatime në të ardhura etj. Aktualisht, organizatat me këtë status nuk kanë gati se asnjë përfitim;
- Mekanizmat konkretë dhe obligues për përfshirjen e shoqërisë civile në vendim-marrje, nëpërmjet vendosjes së obligimeve ligjore në Ligjin për Qeverinë, Rregulloren e Punës së Parlamentit, Ligjin për Vet-qeverisje Lokale, Ligjin për Nisma Legjislative, Ligji për Këshillin Ekonomik-Social etj;
- Krijimi i një ambienti favorizues për qëndrueshmërinë financiare të OSHCve, duke përfshirë edhe miratimin e Ligjit për Sponzorizim, lehtësimeve tatimore për donatorë vendorë në kuadër të Ligjit për Tatim në të ardhura të Koorporatave dhe Ligjit për Tatim në të ardhurat individuale etj.;
- Njohja me ligj e punës vullnetare, jo vetëm në sektorin e rinisë, por në përgjithësi.

**Autoritetet përgjegjëse:** organizatat e shoqërisë civile duhet të ndërmarrin vazhdimisht aktivitete të koordinuara për të rishikuar dhe përmirësuar në vazhdimësi kornizën ligjore e cila e rregullon funksionimin e tyre. Strategjia duhet të adresojë këtë çështje duke garantuar një koordinim të vazhdueshëm në mes përfaqësuesëve të shoqërisë civile dhe organit kompetent në kuadër të Qeverisë që do të jetë përgjegjës për koordinimin e politikave qeveritare ndaj sektorit. Normalisht, bashkëpunimi për të siguruar kornizë ligjore sa më të favorshme për organizatat e shoqërisë civile nuk limitohet vetëm në këtë organ por duhet të përfshijë edhe komisionet parlamentare, ministritë relevante etj.

### **3.2. Përkrahja financiare (direkte dhe indirekte) e qeverisë ndaj organizatave të shoqërisë civile**

Në ndërtimin e një shoqërie të fuqishme civile në Kosovë, është me rëndësi që qeveria jo vetëm të krijojë një mjedis të favorshëm ligjor për funksionimin e organizatave joqeveritare por të ofroj gjithashtu edhe mbështetje financiare për sektorin. Në pothuajse të gjitha vendet e Europës, financimi nga mekanizma të ndryshëm të qeverisë paraqet një përqindje të konsiderueshme të financimit të përgjithshëm të OSHC-ve. Në vitin 2003, përqindja e financimit të OSHC-ve nga fonde qeveritare sillej nga 30% në Suedi e Norvegji deri në 70% në Irlandë dhe Belgjikë, ndërsa në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore nga 20% në Sllovaki deri në 40% në Republikën Çeke.

Mekanizmat e financimit të OSHC-ve nga qeveria si një nga burimet e qëndrueshme të financimit të OSHC-ve akoma nuk kanë arritur në agjendën e qeveritarëve në Kosovë, ndonëse iniciativat sporadike të financimit të OSHC-ve nga ministritë e ndryshme apo nga departamentet e pushtetit lokal nuk kanë munguar gjatë këtyre viteve.

Këto mekanizma nuk do të duhej të kufizoheshin vetëm në fondet qeveritare, por edhe në fondet publike (shih më poshtë dallimin mes këtyre dy llojeve të përkrahjes direkte).

**Autoritetet përgjegjëse:** Përkrahja financiare për OSHC-të në Kosovë nga burime qeveritare dhe publike duhet të fillojë nga njohja zyrtare e rolit të OSHC-ve në zhvillimin e shtetit të mirëqenies nga qeveria dhe nga zotimi i saj për të financuar sektorin e tretë i cili do të përfshihej në dokumentin e bashkëpunimit që do të aprovohej në nivel qendror. Në përgjithësi, ekzistojnë dy mënyra se si qeveria do të mund të ndihmonte financiarisht OSHC-të në Kosovë:

- Financimi indirekt (lehtësimet financiare ndaj OSHC-ve)
- Financimi direkt (sistemet e dhënjes së granteve)

**3.2.1 Financimi indirekt** – nuk nënkupton transferin direkt të parasë apo pronës nga qeveria tek organizatat e shoqërisë civile, por paraqet më tepër një lehtësim që i është bërë OSHC-ve për të

përbushur objektivat e tyre dhe jo për të përbushur obligimet e tyre financiare. Kjo përkrahje nuk mund të shihet në raportet e shpenzimeve direkte të buxhetit publik të një vendi por më tepër raportohet në formë të të mirave të përealizuara, p.sh. në rastin e përfitimeve tatimore, tatimet që nuk mbledhen nga OSHC-të konsiderohen si të hyra të përealizuara apo përkrahje indirekte ndaj OSHC-ve. Përvojat nga rajoni përfshijnë:

- Përrjashtimi nga taksa në profit (Estonia, Sllovenia, Hungaria, Sllovakia)
- Përrjashtimet apo zvogëlimet e TVSH (Sllovakia, Çekia, Estonia për disa aktivitete ka përrjashtime për të tjerat ka TVSH të zvogëluar etj.)
- Përrfitimet nga taksa në të ardhura kur OSHC-të ndërmmarin aktivitete ekonomike (Sllovakia deri në një shumë të caktuar, Polonia nëse përrfitimi përrdoret për projekte në komunitet etj.)
- Shfrytëzimi i hapsirave publike pa pagesë (në Hungari sipas Aktit CÇLII të vitit 1997, OSHC-të kanë të drejtë të shfrytëzojnë pa pagesë objektet publike dhe për më tepër ato mund të bëhen pronare të atij objekti pas 15 vjetësh por vetëm nëse nuk kanë borxhe ndaj shtetit për ato 15 vjet dhe po ashtu nuk kanë të drejtë ta shesin atë pronë).

**3.2.2. Financimi direkt** – nënkupton përrkrahjen financiare të zotuar nga buxheti shtetëror (qendror apo lokal) e cila parashikohet përpara dhe më pas përrfshihet në shpenzimet gjatë atij viti fiskal. Kjo nuk nënkupton patjetër që fondet duhet të shkojnë direkt nga buxheti shtetëror tek xhirollogaritë e OSHC-ve por zakonisht kjo detyrë i delegohet agjencioneve qeveritare ose fondacioneve të ndryshme.

Përveç fondeve qeveritare, shoqëria civile mund të përrfitojë edhe nga fondet publike. Këto fonde krijohen me ligje të veçanta dhe nënkuptojnë orientimin e përrfitimeve nga aktivitete të caktuara publike në fondet për shoqëri civile. Disa nga format më të suksesshme tashmë prezente në Europë janë fondet nga Lojrat e Fatit, fondet nga privatizimi apo forma tjera alternative të financimit publik të sektorit, siç janë Ligjet 1 % të vendeve të Europës Lindore (shih më poshtë për më shumë rreth këtyre formave të financimit).

Ndër dallimet kryesore të këtyre dy llojeve të fondeve është se fonde qeveritare themelohen dhe shpërrndahen me qëllim të aritjes së prioriteteve të qeverisë së caktuar, dhe Qeveria (si donator) e ruan të drejtën e saj për të përrcaktuar qëllimet kryesore të këtyre fondeve, derisa fondet publike themelohen dhe shpërrndahen nga mekanizma të përrbashkët, ku shumica e anëtarëve të organizmit udhëheqës vijnë nga shoqëria civile dhe prioritetet dhe shpërrndarja synon të reflektojë prioritetet publike, e jo patjetër ato të një qeverie të caktuar.

Mekanizmi i funksionimit të kësaj përrkrahjeje financiare duhet të sqarohet në detaje në dokumentin e bashkëpunimit në mes sektoreve, në veçanti duhet të sqarohet mekanizmi i grumbullimit të fondeve, organi që i menaxhon ato fonde dhe procedurat e shpërrndarjes dhe mbikqyrjes së shpenzimit të fondeve.

### **3.2.3. Format e grumbullimit të fondeve për financimin e shoqërisë civile**

Përveç financimeve direkte nga buxheti qendror apo lokal ekzistojnë disa forma tashmë të provuara në vendet e Europës Qendrore për grumbullimin e fondeve për financimin e OSHC-ve të cilat janë përshkruar më poshtë dhe që do të mund të shërbenin si model për Kosovën.

#### Modeli i një përqindëshit (1%)

Ideja qendrore e “mekanizmit të përqindjes” është që taksapaguesit mund të vendosin që të dedikojnë një përqindje të caktuar të taksave të tyre në rrogë tek OSHC-të e caktuara apo tek organizatat tjera bamirëse (kryesisht institucioneve fetare), apo edhe fondi i përgjithshëm i OSHCve.

Hungaria është vendi i parë i cili e ka implementuar një sistem të tillë që nga viti 1996. Sipas Ligjit për Fondin Civil në Hungari, individët dhe kompanitë e biznesit kanë të drejtë që përmes taksës së dedikuar të transferojnë 1% të taksave të tyre tek OSHC-të e preferuara të cilat i zgjedhin ata vetë apo të Fondi Civil në përgjithësi. Ndërkaq qeveria obligohet të kontribuoj me shumën e njëjtë e cila është grumbulluar nga qytetarët. Pra sa më shumë fonde të mblidhen nga qytetarët aq më shumë fonde do të nxirren nga qeveria. Në rastin më të keq, qeveria duhet së paku të derdh në Fondin Civil 0,5% të kontributeve nga rrogat e qytetarëve. Të paktën 60% të buxhetit nga ky fond duhet të shkoj për shpenzimet operacionale të organizatave. Në vitin 2003, modeli i 1% ka grumbulluar 23.5 milion euro në Hungari të mbledhura nga 1% e taksave të 1.4 milion taksapaguesve. Modeli i 1% është aprovuar edhe në Sllovaki (2001), Lituani (2002), Poloni (2003) dhe Rumani (2003).

#### Modeli i i llotarisë

Financimi i OSHC-ve në Kroaci kryesisht realizohet përmes një mekanizmi tjetër grumbullues. Atje qeveria ka vendosur që 50% të fitimeve nga llotaritë të dedikohen për Fondin Nacional Kroat për Përkrahje Shoqërisë Civile. Formë e ngjajshme ekziston edhe në Britani të Madhe, ku Fondi i Llotarisë është ndër fondet kryesore nga të cilat përfitojnë organizatat e shoqërisë civile.

#### Format tjera

Në Hungari ekzistojnë edhe forma tjera të gjenerimit të fondeve për të financuar sektore të caktuara të shoqërisë civile, si p.sh. Fondi Kulturor i cili mbledh fonde nga taksa mbi kiçin dhe pornografinë apo Fondi Ambientalist që grumbullon taksat në derivate apo dënimet e paguara nga ndotësit e ambientit.



#### **3.2.4. Menaxhimi i fondeve**

Grantet për OSHC-të mund të menaxhohen nga vetë qeveria apo ky funksion mund t'i delegohet ndonjë agjencioni qeveritar apo të përzier. Në Kroaci, Fondi Nacional Kroat për Zhvillimin e Shoqërisë Civile është themeluar në vitin 2003, dhe përbën organin qendror për financimin e OSHC-ve në atë vend. Bordi drejtues përbëhet prej 3 përfaqësuesve të qeverisë, 1 përfaqësuesi nga qeveria lokale dhe 5 përfaqësuesve nga shoqëria civile.

Programi i Fondit Nacional Civil në Hungari siguron 34% të të gjitha shpenzimeve të OSHC-ve në Hungari. Fondi përbëhet prej 17 anëtarëve prej të cilëve 12 janë nga shoqëria civile.

#### **3.2.5. Shpërndarja e fondeve**

Kriteri kryesor të cilin qeveritë e përdorin për të përcaktuar se cilat OSHC kualifikohen për fonde qeveritare e publike është "përfitimimi i publikut" apo niveli i përfitimit të komunitetit nga aktivitetet e organizatës dhe jo lloji i aktivitetit të organizatës, p.sh. nëse organizata është shërbyese apo avokuese. Që të dy tipet e organizatave edhe ato shërbyese edhe avokuese punojnë për të mirën e komunitetit megjithëse në përgjithësi ofruesit e shërbimeve e kanë më lehtë të kualifikohen si organizata për përfitim të publikut dhe të marrin financime nga fondet publike. "Ligji i Organizatave për benefit të shoqërisë" (The Law on Public Benefit Organisations) i aprovuar në vitin 1997 në Hungari përcakton kategorinë e "organizatave prominente në shërbim të shoqërisë" që u jepet organizatave joqeveritare të cilat kontrahohen nga organet e shtetit për të ofruar shërbime të caktuara publike. Vetëm 6-8% të OSHC-ve Hungareze e kanë fituar këtë status dhe kjo gjë ka nxitur debat për favorizimin e OSHC-ve që janë të afërta me qeverinë. Sa do që të jetë e vogël kjo iniciativë, megjithatë paraqet një lëvizje pozitive nga e cila mund të mësohet.

Vërejtje! Është shumë e rëndësishme që të krijohen që nga fillimi mekanizma transparente me rastin e shpërndarjes së granteve dhe të definojnë qartë parimet e llogaridhënies përndryshe i tërë procesi rrezikon të politizohet dhe të keqpërdoret. P.sh. auditimi shtetëror në Hungari tregonte se 80% të fondeve që ishin dhënë për OSHC-të kishin qenë vendime të një personi dhe në 50% të rasteve këto fonde ishin dhënë pa shpallur konkurs të hapur. Po ashtu, raportimi i shpenzimeve nga OSHC-të ishte shumë i dobët apo nuk ishte bërë fare dhe fondet ishin shpërndarë jo sipas nevojës reale por sipas shpenzimeve nga viti i kaluar.

Një formë e re, e cila tashmë ka filluar diskutohet rreth mënyrës së mbikqyrjes së këtyre fondeve, është shfrytëzimi i Sistemeve të Sigurimit të Cilësisë (Quality Assurance Systems). Ideja qëndron në themelimin ose mandatimin e organeve të pavarura të cilat do të sigurojnë certifikimin e organizatave për këto sisteme, e të cilat do të pranoheshin nga qeveria si dëshmi e menaxhimit të mirë të fondeve. Kjo do të eliminonte mbikqyrjen direkte nga shteti dhe ndikimin eventual në autonominë e organizatave përfituese.

### **3.3. Kontraktimi i disa shërbimeve publike tek shoqëria civile**

Shoqëria civile është duke realizuar një spektër të gjërë të shërbimeve sociale dhe aktiviteteve në përkrahje të komunitetit të cilat më herët janë përbushur nga shteti. Në shoqëritë moderne kërkesa për shërbime të reja sociale është vazhdimisht në rritje dhe komuniteti është vazhdimisht në kërkim të diversitetit të këtyre shërbimeve. Qeveritë tashmë u janë kthyer proceseve të vendosura nga komunitet në mënyrë që të adresojnë problemet lokale me zgjidhje lokale.

Pjesëtarët e shoqërisë civile në Kosovë mund të jenë pjesëmarrës të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale, qoftë në plotësimin e atyre që ofrohen nga shteti (p.sh. shëndetësia, mirëqenja sociale) apo në ofrimin e shërbimeve të cilat momentalisht nuk mund të ofrohen nga shteti. Shoqëria civile në Kosovë tashmë i ka përbushur disa funksione të rëndësishme publike nëpërmjet të punës së saj për shembull mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut.

Në këtë kontekst, shoqëria Kosovare mund të përfitoj shumë nga shërbimet që mund të ofrohen nga OSHC-të përmes zhvillimit të asaj që sot në botë njihet si ekonomia sociale e që në fakt paraqet aktivitet ekonomik jofitimprurës që mund të përmirësoj kushtet ekonomike, sociale dhe ambientale të komunitetit. Ekonomia sociale mund të jetë burim vital i vendeve të reja të punës, i njohurive dhe aftësive të reja që hapin shtigje të reja punësimi. OSHC-të mund të jenë burim i njohurive sipërmarrëse në fushat ku ekonomia e tregut dështon të ofrojë shërbime efikase.

Ofrimi i shërbimeve nga shoqëria civile në Kosovë mund të bëhet në fushat e barazisë gjinore, kulturës, regjenerimit të ambientit, të drejtave të konsumatorëve, trajnimeve dhe hulumtimeve, punës sociale, përkujdesjes ndaj personave me nevoja të veçanta, edukimit etj.

Rruga përpara: Qeveria në Kosovë mund të delegojë disa nga shërbimet sociale tek shoqëria civile. Si rregull, shteti duhet të ofrojë financim për ekzekutimin e funksioneve të deleguara nga ai, ndërsa paraprakisht duhet të përcaktojë parimet kryesore të ofrimit të këtyre shërbimeve. Ekzistojnë disa modele të financimit të OSHC-ve shërbyese:

*Sistemi i përkrahjes – Gjermani*, paraqet bazën e mirëqenies sociale në atë vend. Ky model bazohet në principin i cili favorizon komunitetin i cili ballafaqohet me një problem që të adresojë dhe zgjidh vetë atë problem. Nëse komuniteti (familja, fqinjët) nuk janë në gjendje apo nuk janë të kualifikuar për t'a adresuar atë problem atëherë përparësi ka OSHC-ja që vepron në atë komunitet. Vetëm atëherë kur as

komuniteti e as OSHC-të e atij komuniteti nuk mund të mirren me atë problem, qeveria i përcakton mekanizmat e saj qeveritarë për t'u ballafaquar me problemin.

*Sistemi normativ – Hungari*, paraqet modelin i cili përcakton që secili entitet që ofron shërbime të cilat janë detyrë e shtetit (përfshirë këtu edhe edukimin, shëndetësinë, dhe shërbimet e mirëqenies sociale) dhe i cili përmbush kriteret e përcaktuara nga shteti duhet të financohet nga qeveria bazuar në numrin e klientëve që i shërben. Për shkak se përkrahja nga qeveria është e bazuar në formulën “për kokë banori” kjo përkrahje quhet “përkrahje normative”. Pra entiteti që ofron këto shërbime do të pranojë ndihmë financiare pa marrë parasysh nëse është institucion publik, OSHC apo kompani biznesi. Kjo ndihmë financiare është e dedikuar kryesisht për shpenzime operationale që nënkupton se OSHC-të duhet të gjenerojnë fonde të tjera për të qenë konkurrues në ofrimin e atyre shërbimeve.

Duhet theksuar që rruga për të përfituar nga fondet qeveritare për këto shërbime nuk është e lehtë për OSHC-të. Sipas Ligjit për Organizatat në Shërbim të Publikut (komunitetit) i cili është aprovuar në vitin 1997 vetëm OSHC-të që e kanë statusin e “organizatës prominente në ofrim të shërbimeve për komunitetin” mund të kualifikohen për ato fonde. Deri më tani vetëm 6-8% të OSHC-ve Hungareze e kanë fituar këtë status.

*Sistemi i konkurrencës – Britani e Madhe dhe Poloni*, paraqet modelin sipas të cilit sa herë që qeveria dëshiron të ofrojë një shërbim që është i renditur në Listën e aktiviteteve për përfitim të komunitetit ajo shpall tender të hapur për të gjitha entitetet. OSHC-të duhet sipas këtij modeli të konkurrojnë me entitetet tjera (institucionet shtetërore apo kompanitë private) për të fituar kontratën në bazë të shërbimeve më të mira dhe më të lira të ofruara.

### **3.4. Fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendim-marrje**

Procesi i bërjes së politikave, ligjeve dhe dokumenteve tjera zyrtare në Kosovë tashmë është kompetencë e organeve të zgjedhura, në nivel qendror dhe atë lokal. Edhe pse bërja e politikave dhe e ligjeve mbetet kompetencë e rezervuar për Kuvendin, Qeverinë dhe Komunitatet e Kosovës, procesi demokratik i qeverisjes dhe vendim-marrjes garanton dhe inkurajon përfshirjen në këtë proces edhe të palëve tjera jashtë autoriteteve publike. Në 10 vjeqarin e fundit autoritetet publike të Kosovës kanë zhvilluar një përvojë domethënëse në politikë-bërje, duke mos lënë anash as përfshirjen e qytetarëve në përgjithësi dhe organizatave të shoqërisë civile në veçanti në këtë proces. Megjithatë, ende nuk është zhvilluar një kulturë e përgjithshme e konsultimit, ashtu siç nuk janë zhvilluar e zbatuar në praktikë teknika për ndërmarrjen e procesit të konsultimit në mënyrë të duhur. Për më tepër, ende nuk ka ndonjë formë të strukturuar dhe të standardizuar të kësaj pjesëmarrjeje. Qeveritë, ministritë apo komunitatet e caktuara kanë nivele, forma dhe mekanizma të ndryshëm të përfshirjes së shoqërisë civile në vendim-marrje, ndërsa organizatat e ndryshme i përgjigjen këtyre iniciativave në mënyrat nga më të ndryshme. Standardizimi i kërkesave ligjore dhe mekanizmave zbatues do të sqaronte pritjet për të dyja palët dhe do ta lehtësonte këtë përfshirje në masë të madhe.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë duhet që të angazhohen që të sigurojnë dialog të strukturuar me qeverinë për të sqaruar mënyrën e pjesëmarrjes së saj në dizajnimin e politikave publike. Shoqëria civile mund të sjell në këtë proces ekspertizën e tyre dhe njohuritë mbi gjendjen lokale si dhe

pikëpamjet e tyre përkitazi me nevojat dhe shqetësimet e shoqërisë në përgjithësi si dhe të grupeve të veçanta dhe sektorëve. Këto këndvështrime jo vetëm që janë esenciale për të siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive – mirëpo gjithashtu edhe për një politikë bërje të mirë të ndërtuar me konsensus të gjerë.

Polonia, në vitin 2002 ka miratuar Rregulloren mbi Dialogun Social, e cila ndër të tjera obligon të gjitha ministrat që, para se të dorëzojnë draft-ligjet në Parlament, jo vetëm të konsultojnë organizatat e shoqërisë civile por edhe të përgatisin përmbledhjen e rezultateve të konsultimit dhe të ofrojnë arsyetimet konkrete për refuzimin eventual të rekomandimeve të OSHCve. Ngjajshëm me këtë, edhe Hungaria ka lansuar Programin e Legjislacionit të Hapur, i cili ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së legjislacionit nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes qytetare në procesin e draftimit dhe mbikqyrjes së zbatimit të ligjeve. Britania e Madhe, duke pasur një traditë jashtëzakonisht të gjatë të konsultimit, tashmë ka mekanizma të shumtë për këtë çështje, ndër të cilat edhe Kodi i Praktikës së Konsultimit, i cili obligon të gjitha autoritetet publike që të gjitha dokumentet e tyre t'i konsultojnë me qytetarë për së paku 12 javë.

I fundit nga këto është Kodi i Praktikave të mira të pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendim-marrjes, i miratuar nga Këshilli i Europës në vitin 2009. Ky kod përcakton parimet kryesore të këtij procesi dhe obligon të gjitha vendet europiane që të përfshijnë këto parime në sistemet e tyre legjislative.

Vërejtje!: Një ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen të dy sektorët në këtë proces është pyetja se cilat organizata duhet të ftohen nëpër procese, forume e trupa të ndryshëm si përfaqësues të shoqërisë civile? Mënyra më e suksesshme e zgjidhjes së këtij problemi është parë te mekanizmat e përzgjedhjes brenda vet sektorit të shoqërisë civile, e cila vet i cakton pjesëtarët e saj që do ta përfaqësojnë, varësisht prej fushave për të cilat ftohet ose dëshiron të përfshihet në proces. Për shembull, Sllovenia mekanizmat e përzgjedhjes i'a ka mandatuar platformës së organizatave të shoqërisë civile CNVOS. Me publikimin e Strategjisë Legjislative të vitit të caktuar, të gjitha organizatat lajmërohen për ligjet të cilat janë me interes për to. Kusht për këtë është që organizata të jetë e profilizuar në fushën e caktuar. Kur Qeveria themelon grupet punuese për ligjet e caktuara, organizatat e lajmëruara paraprakisht zgjedhin në mes vete përfaqësuesin që do të përfaqësojë shoqërinë civile në grupin e caktuar, ndërsa CNVOS kujdeset për mbarëvajtjen dhe koordinim e procesit të përzgjedhjes.

Rruga përpara: Qeveria dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë, së pari në përcaktimin e obligimeve të qeverisë për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në politikë bërje, e pastaj edhe në zbatimin sa më të mirë të këtyre obligimeve. Përshtatja e praktikave të mira europiane duhet të bëhet bashkarisht me qëllim të standardizimit të procedurave të përfshirjes së qytetarëve në vendim-marrje, ndërsa të dyja palët duhet të obligohen dhe njihen me përgjegjësitë e njëra-tjetrës. Qeveria duhet të obligojë zyrtarët e saj që të përfshijnë organizatat relevante qysh në fazat fillestare të hartimit të politikave dhe ligjeve, sikurse edhe të trajnojnë këta zyrtarë për këtë proces. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile duhet të themelojë mekanizmat e përzgjedhjes së brendshme me qëllim të delegimit nëpër

forume, procese e trupa qeveritare të përfaqësuesëve relevantë e që mund të kontribuojnë më së shumti në përmirësimin e cilësisë së politikave e ligjeve të caktuara.

### **3.5. Roli i shoqërisë civile në integrimin e Kosovës në BE**

Kriteret e Kopenhagës për vendet candidate dhe potenciale candidate që pretendojnë të anëtarësohen në Bashkimin Europian përveç tjerash kërkojnë edhe nivel të caktuar të zhvillimit të shoqërisë civile si një indikator i vitalitetit të demokracisë në një vend. Andaj, kriteret politike, si kriter i parë nga tri kriteret e Kopenhagës e që përcaktojnë stabilitetin e institucioneve në një vend kandidat e vlerësojnë zhvillimin e shoqërisë civile si një parakusht i cili garanton demokracinë, sundimin e ligjit, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara dhe pakicë të cilat janë kushtet themelore që duhen të përmbushen nga vendet candidate. Rruga të cilën e kanë ndjekur shtetet candidate në procesin e anëtarësimit në BE ndryshon nga vendi në vend por shumica e tyre ka zgjedhur ose ta përfshijë shoqërinë civile në dialog me BE-në që nga fillimi ose kanë bërë përpjekje për të zhvilluar OSHC-të e vendit të tyre për të qenë të përgatitura për të tërhequr fonde nga BE-ja përmes të cilave të ndikojnë në arritjen e disa standardeve dhe përmbushjen e disa kriterëve kryesisht nga kriteret politike. Për më tepër, dialogu civil së fundmi është futur si kriter zyrtar i cili vlerësohet në kuadër të procesit të antarësimit të vendeve candidate në Bashkimin Europian, ndërsa rëndësia e demokracisë pjesëmarrëse dhe dialogut civile janë të përfshira si një parim i rëndësishëm edhe në Nenin 11 të Traktatit të Lisbonës.

Të gjitha vendet e reja anëtare të antarësuara në BE në Maj të vitit 2004 kanë përfshirë shoqërinë civile në dialogun e tyre me BE-në, si dhe procesin e reformave të brendshme për të plotësuar kriteret e antarësimit. Vendet më të suksesshme, si Sllovenia dhe vendet baltike, kanë pasur nivel më të thellë të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Për më tepër, edhe vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi e Maqedonia tashmë kanë vendosur struktura të veçanta për këtë fushë. Në Kroaci, përfaqësues të shoqërisë civile janë pjesë e të gjitha 35 grupeve negociuese me BE-në, sipas kapitujve, ndërsa ngjajshëm shoqëria civile përfaqësohet edhe në Komitetin Kombëtar për Monitorimin e Negociatave të Antarësimit (niveli parlamentar) dhe Komitetin Monitorues të programeve të IPA-s (niveli qeveritar). Në Maqedoni, Sekretariati për Çështje Europiane është organi kompetent për bashkëpunim me shoqëri civile, ndërsa Departamenti për koordinim të fondeve të BE-së brenda këtij sekretariati ka për detyrë përfshirjen e OSHC-ve në përgatitjen e projekteve për IPA. Së fundmi, Maqedonia ka themeluar Këshillin Kombëtar për Integrim Europian i cili përbëhet nga përfaqësues të Parlamentit, Qeverisë dhe shoqërisë civile. Ministria e Integritit Europian të Malit të Zi, në Tetor 2009 ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për bashkëpunim me OSHC për çështjet e integritit europian. Aktiviteti i parë i përbashkët konsiston në përkushtimin për implementim të përbashkët të Strategjisë për Komunikim të kësaj ministrie.

Druga përpara: Procesi i integritit European të Kosovës është një proces kombëtar dhe kërkon angazhimin e gjithë shoqërisë dhe potencialit njerëzor të vendit. Siç thotë edhe Raporti i Progresit i Nëntorit 2010 OSHC-të Kosovare kanë për të ofruar shumë në këtë proces dhe Qeveria e Kosovës ka shumë arsye për të afruar organizatat e shoqërisë civile në dialogun me institucionet e BE-së në rrugën e saj të gjatë të anëtarësimit në këtë strukturë. Ministria e Integritit European, e themeluar në pranverë të vitit 2010, ka bërë disa hapa fillestarë drejt këtij dialogu, por sa më parë këto nisma duhet të konkretizohen në angazhime konkrete nga të dyja palët. Si hap i parë, OSHC-të duhet të përfshihen në strukturat ekzistuese të dialogut të Kosovës me BE-në, siç janë Këshilli për bashkëpunim i nivelit të lartë apo edhe grupet punuese sektoriale të dialogut të procesit të Stabilizim-Asociimt.. Gjithashtu, zyrtarët për integrim european në ministritë e linjës mund të obligohen që të ndërtojnë kontakte të rregullta me OSHC-të e fushave të tyre, sikurse që mund të përfshijnë shoqërinë civile në planifikimin e rregullt të fondeve të IPA-s, nëpërmjet shpërndarjes për konsultim të “projekt-fisheve” por edhe të dokumenteve shumë vjeqare planifikuese si IPA vjetore dhe MIPD.

Për të përfutur sa më shumë nga të gjitha këto, Qeveria respektivisht Ministria për Integrim European duhet të investojë në ngritjen e kapaciteteve të OSHCve për tu marrë sa më profesionalisht më këtë proces, nëpërmjet fondeve dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore për këto organizata. Me avancimin e Kosovës në rrugën e saj drejt antarësimit në BE, roli i shoqërisë civile në këtë proces duhet të ngritet paralelisht. Hap pozitiv nga Komisioni European të cilin duhet ndjekur edhe institucionet vendore është se nga viti 2011 OSHC-të janë ftuar të komentojnë dhe të shprehin rekomandimet e tyre gjatë ciklit të takimeve sektoriale në kuadër të dialogut për PSA.

#### **4. Historiku i bashkëpunimi në mes shoqërisë civile dhe qeverisë në Kosovë**

Përkundër periudhës dhjetëvjeqare të bashkë-ekzistimit, përpos disa iniciativave të papërfunduara dhe në disa raste të vullnetit politik të disa udhëheqësve në Kosovë, bashkëpunimi në mes organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisë ka ngelur akoma në nivel sporadik. Në rastet e rralla kur ky bashkëpunim ndodhë, ai është më tepër rezultat i kontakteve apo njohjeve personale të politikanëve dhe përfaqësuesëve të shoqërisë civile ose rezultat i nevojës së politikëbërësve për të përmirësuar imazhin e tyre publik. Shpesh herë, kjo formë e bashkëpunimit ad-hoc është kritikuar nga vet organizatat e shoqërisë civile, të cilat pretendojnë se janë lënë anash forumeve dhe diskutimeve të rëndësishme vetëm për faktin që nuk kanë pasur kontakte e njohje personale me vendim-marrësit, duke bërë që qeveria t’i ftojë në bashkëpunim vetëm ato organizata që i konsideron të afërta me të, e me këtë të pretendojë që ka përmbushur obligimin e konsultimit të këtij sektori. Në anën tjetër, politikë-bërësit arsyetohen me faktin se shoqëria civile është aq e gjërë dhe aq e paorganizuar, saqë e kanë të pamundur që t’i kenë informatat e sakta se cilën organizatë apo përfaqësues të shoqërisë civile duhet ftuar në aktivitetet specifike. Për pasojë, e gjithë ekspertiza e cila është akumuluar gjatë këtyre viteve në mesin e organizatave të shoqërisë civile ka ngelur në masë të madhe e pashfrytëzuar nga vendimmarrësit në Kosovë.

Procesi i negociimit dhe ndërtimit të partneritetit dhe bashkëpunimit të strukturuar Qeveri - Shoqëri Civile në Kosovë u nis me iniciativën e sektorit civil në bashkëpunim me sektorin qeveritar në vitin 2007.

Në ambient përkrahës dhe në një proces gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesëve nga dy sektorët e të lehtësuara nga ekspertë vendorë, janë bërë analizat dhe debatet e para mbi mundësinë dhe nivelet e bashkëpunimit institucional, duke u shërbyer me metodologjinë e kornizës logjike si qasje analitike në raportet shkak-pasojë.

Më Qershor 2007, në një seminar pune me pjesëmarrje nga të dy sektorët u identifikuan rreth 150 probleme në fusha të ndryshme dhe në konsensus u përcaktuan fushat problematike, u bë përkufizimi i objektivave dhe veprimet e nevojshme për përmbushjen e tyre.

Pas seminarit që njëkohësisht nënkuptoi fillimin e bashkëpunimit praktik midis qeverisë dhe shoqërisë civile, u organizuan debate publike në 7 rajonet e Kosovës me pjesëmarrje të qindra organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të pushtetit lokal e të facilituar nga moderatorë të organizatës KEC<sup>1</sup>. Në këto debate u parashtruan për diskutim dhe debat fushat problemore të identifikuara si pozita e sektorit të shoqërisë civile, përgjegjësitë – përmbushja e misionit të organizatave të shoqërisë civile, përgjegjësitë e Qeverisë ndaj shoqërisë civile dhe bashkëpunimi Qeveri-Shoqëri Civile.

Këto përpjekje rezultuan me formalizimin e iniciativës së organizatave të shoqërisë civile, duke themeluar në Shtator të vitit 2007 Platformën CiviKos, ndërsa nëpërmjet saj duke nënshkruar me Qeverinë e Kosovës një Memorandum Bashkëpunimi për bashkëpunimin mes Qeverisë dhe shoqërisë civile në Nëntor të po atij viti.

Formalizimi i pritjeve dhe obligimeve nga ana e dy sektorëve i konceptuar në formën e Memorandumit për Bashkëpunim deri më tani nuk arriti të konkretizohej në përfitime konkrete për asnjërën palë. Problemet organizative dhe në burime njerëzore të Platformës, të shoqëruara me interesimin e zvogëluar të Qeverisë bënë që ky dokument të mbetet vetëm në letër dhe asnjëherë të mos gjejë zbatim.

Megjithatë, ky Memorandum ende mbetet dokumenti i vetëm zyrtar i nënshkruar nga të dyja sektoret dhe mund të shërbejë si një bazë e mirë për avancimin e tij në një Strategji të bashkëpunimit mes Qeverisë dhe shoqërisë civile.

Kohëve të fundit, me pavarësimin e vendit dhe marrjen e kompetencave të plota nga ana e institucioneve vendore, ndër-veprimi mes shoqërisë civile dhe shtetit ka shënuar rritje, qoftë në formë bashkëpunimi apo edhe kritike e konfrontimi. Megjithatë, ky ndër-veprim ende zhvillohet në mënyrë ad-hoc dhe pa i'u nënshtruar rregullave të qarta të cilat do të siguronin përfaqësim të duhur të shoqërisë civile dhe marrëdhënie të strukturuar me Qeverinë dhe autoritetet tjera publike në Kosovë.

---

<sup>1</sup> KEC- Qendra Kosovare për Edukim

*Kjo analizë është përkrahur nga:*

**Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)**

**Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (ISC) / USAID**

**Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)**